



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR

Peshkopi, më 16.05.2023

NJOFTIM

MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË APLIKANTËVE PËR KONKURIMIN NË NJË VEND VAKANT NË POZICIONIN E PUNËS “KRYETAR DEGE BUXHET-FINANCË”

Bazuar në nenet 74, 75, 76 dhe 77 të ligjit nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, urdhrin nr.54, datë 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e strukturës organike të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, urdhrin nr.13, datë 28.04.2023 të drejtuesit të Prokurorisë Dibër “Për fillimin e procedurës së konkurimit për emërimin në pozicionin e punës “kryetar dege buxhet-financë”, komisioni i vlerësimit i miratuar me urdhrin e drejtuesit të Prokurorisë Dibër nr.14, datë 28.04.2023, bazuar në procesverbalin e mbajtur me datë 16.05.2023 “Për vlerësimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët që konkurojnë për pozicionin e punës kryetar dege buxhet-financë”, vendosi si më poshtë vijon:

-Aplikantët z.Ervin Selishta, znj.Antigona Paci dhe znj.Xhoslida Elezi, kanë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të posaçme dhe kalojnë fazën e parë të verifikimit paraprak të dokumentacionit.
-Aplikatia znj.Gjylsime Hida, nuk ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të posaçme dhe nuk kalon fazën e parë të verifikimit paraprak të dokumentacionit pasi nuk ka përfunduar master shkencor në shkencat ekonomike por rezulton vetëm me diplomë “Bachelor”.

Njoftohen aplikantët që janë kualifikuar për në fazën e dytë se:

-Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 22.05.2023, ora 11:00, në mbjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

-Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datën 25.05.2023, ora 11:00, në mbjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

KOMISIONI I VLERËSIMIT

ARDITA ÇELA

ALDO PUCA

BRONILDA DODA